



VENDIME JASHTË MBLEDHJEVE TË BORDIT

Vendimi Nr. 2024-K05

Data: 16 Mars 2024

Përfshirja e turneve “Albanian dhe Ulqin Bowl” në kalendarin e FTK-së.

Kryetari Jeton Hadërgjonaj merr vendim për përfshirjen e turneve “Albanian Bowl”, “Ulqin Bowl” në kalendarin zyrtar të federatës së tenisit të Kosovës.

Rezultatet nga këto turne do të përfshihen edhe në ranglistat zyrtare të FTK-së.

Vendimi Nr. 2024-K03

Data: 20 Mars 2024

Albania Bowl 2024

Kryetari Jeton Hadërgjonaj merr vendim për mbështetjen e tenisistëve për pjesëmarrjen e tyre në Albanian Bowl 2024, që do mbahet nga data 23-24 mars në Shkodër- Shqipëri.

Shpenzimet që do rimburohen do të jenë të ushqimit dhe akomodimit.

Vendimi Nr. 2024-K04

Data: 15 Prill 2024

Ulqin Bowl 2024

Kryetari Jeton Hadërgjonaj merr vendim për mbështetjen e tenisistëve dhe trajnerëve për pjesëmarrjen e tyre në Ulqin Bowl 2024, që do mbahet nga data 04-05 maj në Ulqin.

Shpenzimet që do rimburohen do të jenë të ushqimit dhe akomodimit dhe transport.

Vendimi Nr. 2024-K05

Data: 10.05.2024

Kryetari merr vendim për emërimin e trajnerit mental Senad Jusufi si kordinator për programin e JTI i drejtuar nga ITF.

Me këtë vendim Senad Jusufi do të jete përgjegjës për postin e National JTI Coordinator nga vitit 2024.

Senad Jusufi pas kërkesës se Kryetarit ka konfirmuar marrjen e përgjegjesisë për këtë detyrë dhe i njejtë do ti përgjigjet kërkesave të ITF për këtë program.



Vendimi Nr. 2024-K05

Data: 10.05.2024

Përkrahja e Amar Jusufit në turneun Smirkva Bowl

Kryetari Hadërgjonaj aprovon kërkesën e Senad Jusufit për mbështetjen e tenisit Amar Jusufi në turneun “ Smirkva Bowl” i cili do të mbahët në Pula të Kroacisë nga data 23-30 qershor 2024.

Federata do të mbuloj shpenzimet sipas rregullores 03 për turnet jashtë vendit.